



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencijsa za Razvoj Poloprivrede/ Agriculture Development Agency

THIRRJE PËR APLIKIM
PËR FERMERËT DHE EKONOMITË BUJQËSORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËR PËRFITIM NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË “PLANIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2014-2020”, **MASA 101 “INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË EKONOMITË BUJQËSORE”** SEKTORI I PEMËVE, SEKTORI I RRUSHIT.

1. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e mbështetjes financiare/granteve për investime në ferma në kuadër të Masës 101 “INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË EKONOMITË BUJQËSORE”, sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, për vitin 2017 për sektorin e pemëve dhe sektorin e rrushit.

1. Aplikuesit e pranueshem

- Aplikuesit e pranueshem për këtë masë janë personat fizik dhe juridik. Ata duhet të jenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës;
- Nëse aplikuesi është person fizik, ai duhet të jetë së paku 18 vjeç, por jo më i vjetër se 65 vjet. Në rastin e personave juridik ky kriter nuk aplikohet;
- Personi fizik duhet ta ketë të përfunduar së paku shkollën e mesme dhe dy vjet përvojë pune në lëmin në të cilën aplikon. Aplikuesit që nuk kanë përvojë pune dy vjeçare, duhet të ndjekin kurse trajnimi me së paku 20 orë mësimi, në fushën për të cilën aplikojnë, e të cilat do t'i përfundojnë para kërkesës për pagesën e fundit;
- Në rastin e personave juridik, kërkesa e sipërpërmendur vlen për pronarin ose për personin e punësuar të ndërmarrjes. Personi i punësuar duhet të ketë kontratë pune jo më të shkurtër se tre vjet;
- Aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera detyrimet tatimore dhe atë, personat fizik, tatimin në pronë, kurse personat juridik, tatimin në të ardhura të korporatave dhe tatimet e tjera të aplikueshme;

2.Shtrirja gjeografike

Tërë territori i Republikës së Kosovës.

3.Sektori i pemëve

3.1Kriteret e investimeve në sektorin e pemëve (molla, dardha, kumbulla, vishnja, qershia, kajsia, pjeshka, ftoni, dredhëza, mjedra, manaferra, boronica dhe aronia)

- Në momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet dhe të regjistruar në Regjistrin e Fermave dhe atë së paku 1 hektar për pemë drufrutore (molla, dardha, kumbulla, vishnja, qershia, kajsia, pjeshka, dhe ftoni) dhe/ose 0.50 hektar për pemë manore (dredhëza, mjedra, boronica, manaferra dhe aronia). Sipërfaqja minimale e ngastrës për pemë manore duhet të jetë 0.25 hektar dhe për pemë drufrutore 0.50 hektar;
- Përfituesit për ngritje të pemishteve të reja, para kërkesës për pagesë, nëse blejnë fidanë të prodhuar në Kosovë, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush kriterin CAC (ConformitasAgraria Communitatis) dhe kopjen e licencës së prodhuesit, kurse ata që blejnë fidanë të importuar nga vendet e BE-së, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush së paku kriterin CAC të lëshuar nga prodhuesi, certifikatën për prejardhjen e origjinës dhe lejen e importit të ndërmarrjes importuese.
- Fidanët e mbjellë të pemëve drufrutore duhet të kenë të ngjitur në trup etiketën e institucionit certifikues.
- Projektet e nen mases se pemeve manore, duhet qe te perfshijne ndertimin e depos ftohese dhe ate: projektet me siperfaqe ≥ 0.50 ha - < 1 ha duhet te ndertojne depo me kapacitet se paku 10 t, ndersa projektet me siperfaqe ≥ 1 ha - ≤ 2 ha duhet te ndertojne depo me kapacitet se paku 20 t.

3.2 Investimet në Sektorin e Pemëve

- Investimet në ngritjen e pemishteve të reja me sipërfaqe minimale prej 1 hektar për pemë drufrutore dhe 0.50 hektar për pemë manore;
- Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes në fermë, sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Investimet në prodhimin e energjisë eficiente në fermë nga të gjitha llojete burimevetëripërtërishme;
- Investimet në sistemin e rrjetave për mbrojtje nga breshëri;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për pemishte, për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;
- Investimet për blerje të traktorit për pemët dru-frutore
- Për pemët manore blerja e traktorëve është investim i papranueshëm;
- Investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve për aktivitetet e pas vjeljes, objekteve për vendosjen e makinave, si dhe depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale.
- Investimet në dhoma për ftohje ose frigorifer për pemët manore;

4.Sektori i rrushit

4.1 Kriteret e investimeve në Sektorin e Rrushit

- Në momentin e aplikimit, aplikuesit për investime në sektorin e rrushit duhet të dëshmojnë se kanë tokë bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet, dhe të regjistruar në Regjistrin e Fermës dhe atë së paku 0.3 hektar. Sipërfaqja minimale e ngastrës duhet të jetë 0.1 hektar.
- Në rast të investimeve në mekanizim dhe pajisje për kultivim dhe vjelje, si dhe depo për trajtim pas vjeljes, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë së paku 3 hektarë me vreshta, në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet, të regjistruar në Regjistrin e Vreshtave dhe në Regjistrin e Fermës. Kontrata për qiramarrjen duhet të jetë e noterizuar.
- Përfituesit për ngritje të vreshtave të reja, duhet të blejnë vetëm fidanë të importuar nga vendet e BE-së, përveç varieteteve: Vranac, Prokupë, Smederevka, Kallmet, Sheshi i Zi, Sheshi i Bardhë, të cilat mund të jenë të prodhuara edhe në vend ose ndonjë vend tjetër jashtë BE-së. Bashkë me kërkesën për pagesë, përfituesit duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor të lëshuar nga prodhuesi, certifikatën mbi prejardhjen e fidanëve dhe në rastin e fidanëve të importuar edhe lejen e importit të ndërmarrjes importuese.

4.2 Investimet në Sektorin e Rrushit

- Investimet në ngritjen/modernizimin e plantacioneve të vreshtave (konvertim, zëvendësim) për rrush të tryezës dhe rrush të verës me madhësi minimale 0.3 hektar;
- Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes, sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Investimet në vendosjen e plasmasit për rrush të tryezës;
- Investimet në prodhim të energjisë eficiente në fermë nga të gjitha llojet e burimevetëripërtërishme;
- Investimet në sistemin e rrjetave për mbrojtje nga breshëri;
- Investimet në sisteme mbajtëse të hardhive dhe në rrethoja;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për vreshta, makineri për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;
- Investimet për blerje të traktorit;
- Atyre që kanë mbi 3 hektarë sipërfaqe me vreshta u lejohet edhe aplikimi për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim;

5. Dokumentet e nevojshme

Për të aplikuar për Masën 101- në sektorët përkatës, dokumentet e nevojshme mund t'i gjeni në Udhëzuesit për aplikues, në uebfaqen e AZHB-së dhe në zyrat rajonale përkatëse.

6. Shkalla e përkrahjes publike

- Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 10,000 €, përveç projekteve për pemë manore dhe projekteve të sektorit të rrushit, ku vlera minimale e projektit është 5,000 €.
- Përkrahja publike është 60% e shpenzimeve të pranueshme të investimit përveç për traktor me ç' rast përkrahja publike është 20% e cila nuk rritet as për zona malore as për të rinjë.
- Përkrahje shtesë prej 5% jepet për investime në zonat malore dhe 5% për fermerë të rinj (40 vjeç ose më të rinj).

-

7. Koha dhe mënyra e pranimit të aplikacioneve

Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita e publikimit të thirrjes për aplikim,

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur nga data 06 shkurt deri më 20.03.2017

Vërejtje: Aplikacioni duhet të përmbajë të gjitha dokumentet e kërkuara dhe të dorëzohet në afatin për aplikim. Dosja e aplikacionit dorëzohet në dy kopje fizike dhe të gjitha dokumentet e dosjes fizike skanohen dhe ruhen në një CD e cila dorëzohet bashkë me kopjet fizike. Këshillohen aplikuesit që një kopje të dosjes ta ruajnë për nevoja të veta. Këshillohen aplikuesit që të aplikojnë së paku 5 ditë para përfundimit të afatit për aplikim që të kenë mundësi të kompletojnë dokumentacionin e tyre në raste të mungesës së ndonjë dokumenti.

Formulari për aplikim dhe dokumentet e bashkëngjitura duhet të dorëzohen në zyrën Rajonale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjiilan nga ora 08:30-16:00 çdo ditë pune,

8. Kontaktet dhe pikat (vendet) informuese lidhur me aplikimin

MBPZHR /AZHB MBPZHR /AZHB Adresa: (Ndertesa ish Banka e Lublanës) Prishtinë Nga e hëna deri të premten: nga ora 10:00 – 12:00 dhe nga ora 13:00-15:00 tel 038/211-967 ose 038/212-647				
---	--	--	--	--

Zyret Regjonale të AZHB-së çdo ditë pune nga ora 08:30-16:00				
Nr.	Rajoni	Adresat	Telefoni	e-maili
1	Prishtinë	Zona Industriale - Fushë Kosovë, përballë Maxi-Marketit	038 601 169	
2	Mitrovicë	“Mbretëresha Teutë” pa nr.	028 522 501	
3	Pejë	Instituti Bujqësor “Fidanishtja” Pejë	039 431-276	
4	Gjakovë	“Marin Barleti” nr. 2, kati III.	0390 320-992	
5	Prizren	“Avni Rrustemi” 159	029 244-793	
6	Ferizaj	“Dëshmorët e kombit” pa nr.	0290 324 661	
7	Gjilan	Rr. “Bulevardi i Pavarësisë” (Rr. e Ferizajit) (Soliteri, kati I)	0280326106	

Për informata më të hollësishme vizitoni uebfaqen www.mbpzhr-ks.net, uebfaqe www.azhb-ks.net